

Programi BAS administrohet nga BERZH dhe synon mbështetje për zhvillimin dhe rritjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare.



TAM/BAS: Çelësi në ndihmën ndaj SME-ve në kohë të vështira

Programet TAM dhe BAS përfaqësojnë skema perplotuese që synojnë të ndihmojnë ndërmarrjet private të pershtatën ndaj kërkesave të ekonomisë së tregut.

Ekipi i TAM/BAS mbledhi menaxherët, drejtorët e zyrave lokale, ekspertët kryesorë dhe përfaqësuesit e donatorëve në Zyrat Qëndrore për të diskutuar rezultatet e vitit të fundit dhe objektivat e 2009 në kuadër të situatave të turbullta ekonomike aktuale.

Në fjalimin e tij, Presidenti i BERZH, Z. Mirow shprehu vlerësimin e tij për punën e TAM/BAS dhe falenderoi donatorët për mbështetjen sistematike të dhënë për aktivitetet e programit.

Duke ju referuar mjedisit ekonomik, Presidenti tha: “Sot jemi përballë krizës më të rëndë që ka përjetuar një gjeneratë. Ne kemi hartuar paketat në përgjigje të krizës me fokus sektorin e financës dhe ekonominë reale. Mirëpo kriza aktuale nuk mund të zgjidhet vetëm me mjete financiare, dhe BERZH mund të ofrojë më shumë se financa. Në TAM/BAS ne kemi një burim unik në ndihmë për administrimin e krizës në sektorin privat. Menaxhimi i fortë e i spikatur është thelbësor, dhe ndërmarrjet duhet të rivlerësojnë modelet dhe planet e tyre të biznesit, e të shohin me sy kritik të gjitha aspektet e operacioneve të tyre. Të bësh biznes gjithmonë ka qënë ekuivalente me përshtatjen, por kurrë kjo nuk ka qënë më e rëndësishme sesa tani”. Drejtoresha e programeve TAM/BAS, Charlotte Salford, së bashku me manaxheren e TAM Caroline Bosa dhe të BAS, Valeria Della Rosa paraqitën rezultatet e programit për vitin 2008.

vijon në fq. 2

Pregatitja e këtij buletini u mbështet nga Qeveria Portugeze

NEON sha Standarti i ngjyrave që rriten



Inxhinier mekanik që prej viti 1989, Durim Shehu vazhdon të ëndërrojë si pakkush... “Kur në vitin 1998 themelova në Tiranë kompaninë NEON, nuk e dija si do të shkonte. Unë dija vetëm një gjë: do të isha i ndershëm me klientët.” – tregon inxhinier Durimi me drojë se kjo nuk besohet lehtë në Shqipëri. Kompania NEON sha nisi si një aktivitet i thjeshtë tregtar, duke importuar

dhe tregtuar materiale ndërtimi dhe rifinitura, kryesisht bojëra. Në harkun e 3-4 viteve, Neon sha. kaloi në prodhimin e disa produkteve, që tregu i mirëpriti ngase ruanin cilësinë europiane. Durim Shehu sot është krenar që kompania e tij mbetet e vetmja e këtij sektori me një rrjet shërbimshpërndarjeje, që mbulon pothuaj gjithë territorin e Shqipërisë.

vijon në fq. 3

Histori suksesi

DEA Studio – E bukura që nuk vdes...

Nëse për shqiptarët DEA është simboli i bukurisë antike të tyre, për Ervin Taçin dhe shokët e tij të DEA Studio ajo është simbol i perfeksionit që vjen në Design, Engineering, Architecture...DEA Studio u krijua në vitin 2002, si sfidë profesionale e një bërthame arkitektësh të rinj, mendjehapur për të tejkaluar kufijtë e përvojës shqiptare në projektim, drejt tendencave më bashkëkohore ndërkombëtare. Filozofia e DEA Studio gjën fillesën e saj tek ato që arkitekti romak Vitruvius shekuj më parë i shpallte si tre cilësitë e një ndërtese “firmitas, utilitas, venustas”



– (e qëndrueshme, funksionale, e bukur), ndërsa shkon drejt përcaktimit të një koncepti dhe identiteti dallues për çdo krijesë të projektuar.

vijon në fq. 2

**DEA Studio – E bukura që nuk vdes...
vijon nga fq. 1**

“Këtë vendosëm të përmbushim edhe ne kur zgjodhëm për t’i ndihmuar që të realizonin katalogun e tyre prezantues” – thotë Neritan Mullaj, drejtor kombëtar i programit BAS. “Nëse aspirata e tyre ishte europiane, e tillë ishte edhe puna që ne zgjodhëm të mbështesnim”.

Sot Ervin Taçi është krenar teksa prezanton punët e DEA studio:

“Çdo krijesë që ne mëtojmë të sjellim në jetë ka një thelb identitar brenda konceptit të bashkëveprimit social, i cili është shumë i rëndësishëm të ruhet në një botë që zmadhohet çdo ditë me të njëjtën përmasë që edhe i humb vlerat themeltare njerëzore”.

DEA studio është asistuar nga programi BAS në Shqipëri për të ndërtuar një imazh identitar, përmes një katalogu prezantues dhe një internet-faqe, për të cilin po punohet.

“Tani kemi një prezantim dinjitoz përmes katalogut, ndërsa po punojmë me BAS për një ëëbsite që të na përfaqësojë, sepse është e vështirë të shpërfaqësh profilin e një studioje arkitekture...” thotë z.Taci, me shumë mirënjohje për BAS-in.



12 urbanistë dhe arkitektë, bashkë me partnerët e tyre të fushës së projektimit kanë realizuar ndër të tjera rreth 71 projekte arkitekture, 6 projekte planifikimi urban, 16 studime urbanistike, dhe shumë supervizione apo konsulenca profesionale në 7 vite aktivitet, ndërsa gjurmët e tyre prekin një hartë të gjerë gjeografike në Shqipëri; Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Sarandë, Lezhë, etj. DEA Studio ka realizuar punë të rëndësishme edhe në vende të tjera të botës.

**TAM/BAS: Çelësi në ndihmën ndaj
SME-ve në kohë të vështira
vijon nga fq. 1**

Në total kanë filluar 1,286 projekte – shumë përmbi objektivin për 1,128 – dhe mëse €15 milion janë angazhuar në mbështetje të ndërmarrjeve. Znj. Salford theksoi se prioriteti më i lartë për vitin 2009 do të jetë krijimi i grupit TAM/BAS për përgjigje ndaj krizës, me synimin për të ndihmuar SME-të të përballojnë rënien ekonomike, sidomos në vendet në tranzicion dhe rajonet rurale, të cilat konsiderohen zonat më të cënueshme në këtë klimë. Një tjetër synim për programet TAM dhe BAS është të punojnë së bashku dhe të kombinojnë aftësitë e tyre si një nismë e vetme. Olivier Descamps, Drejtori i Grupit të Biznesit për Europën Jug Lindore, Kaukazin dhe Azinë Qëndrore tha: “ Nuk është fjala për një biznes si zakonisht” Ai theksoi efektet negative të krizës ekonomike në sektorin e Ndërmarrjeve mikro, të vogla e të mesme në vendet ku programet janë aktive, si dhe domosdoshmërinë për fondet e ardhshme që i nevojiten programeve TAM/BAS. “Mbështetja e TAM/BAS-it ndaj SME-ve është e vlerësueshme tani si kurrë më parë dhe është përgjegjësia jonë të sigurojmë mbijetesën e sa më shumë bizneseve të vogla”.





Mbi 1,000 dyqaneve në të gjithë vendin u shërbehet përmes 14 menaxherëve, të cilët janë në kontakt të vazhdueshëm me ta. Çdo porosi përmbushet më së shumti në harkun e tre ditëve, për zonat më të thella. Kompania ka ngritur parkun e transportit me mbi 20 automjete të tipeve të ndryshme dhe me një kapacitet transportues rreth 200 ton në ditë, për të përballuar në kohë kërkesat e klientëve. “Ky aktivitet në rritje i kompanisë duhej të shoqërohej me stantartizimin e menaxhimit të cilësisë”. Inxhinier Shehu thotë se ky mekanizëm funksionon falë një strukturimi shumë të mirë të punës: “Na ka ndihmuar veçanërisht programi BAS, për implementimin e standartit ISO, në 2007. Ky standart çertifiko i standartin e cilësisë së menaxhimit, ndërsa formësoi

edhe mënyrën e funksionimit të kompanisë, duke e bërë punën e stafit më të frytshme dhe organizimin më efektiv. Tani asgjë nuk ndodh rastësisht, që nga ndarja e punës e deri tek mbajtja e përgjegjësive” Përmbushja e këtij standarti solli rritjen e ndjeshme të prodhimit të përgjithshëm të kompanisë, gjatë vitit 2008 me 30%, ndërsa gama e prodhimeve NEON është zgjeruar edhe me disa produkte të reja. Kompania Neon e nisi aktivitetin e saj me rreth 8 punëtorë, ndërsa

sot numëron 60 punonjës të kualifikuar.

Qysh prej vitit 2005 kompania e zgjeroi aktivitetin në Kosovë me degën “NEON NTSH”, e vendosur në Prishtinë, duke ju shërbyer mbi 200 klientëve në shumicën e territorit të Kosovës.

“Ne operojmë në një treg ende të pastabilizuar. Megjithatë çdo biznes mund të ngrejë një profil të mirë nëse respekton standarte cilësie dhe orientohet nga një konsulencë e specializuar. Ky qe fati ynë me programin BAS”- shprehet mirënjohës Durim Shehu. Ëndrra e radhës së inxhinierit, që dashuron teknologjinë e mirë, është ngritja e një stabilimenti modern për prodhimin e bojërave, më të madhin në rajonin e



Ballkanit Perëndimor. Durim Shehu vazhdon të ëndërojë, ndërsa drejton me pasion NEON sha, fabrikën e tij të ëndrrave....



London Language Institute – Grow English style

Shembellen si nje zonjuszeh e hijshme amerikane. Por pasi prezantohet, meson se zonjusha e bukur 10 vjeçare quhet Kristina Gjoka dhe është ndër nxënëset e para të London Language

Institute, në Tiranë. Kristaq dhe Marilda Gjoka – themelues të kësaj qendre - trupëzuan tek vajza e tyre ëndrrën e herët për të ngritur një institut për mësimin jo thjesht të gjuhës angleze, porse të folurisë anglisht.

“Sepse një gjuhë nuk është thjesht gramatika apo pasuria leksikore e saj. Për t’iu qasur një gjuhë të huaj duhet të brendësosh tingullin, ritmin, pulsmin e saj.” - thotë Marilda Gjoka. Familja Gjoka u kthye në atdhe pas 10 vitesh emigracion për të jetësuar këtë ide të kthjellët në vitin 2000.

London Language Institute është sot më shumë se një qendër për mësimin e anglishtes. Në një staf prej 11 pedagogësh, 4 prej tyre janë folës të lindur të anglishtes, që u zbulojnë fëmijëve

një gjuhë të re përmes shpirtit të lojës dhe ndërkomunikimit të çlirët njerëzor. Me metodat më të mira dhe teknologjinë e fundit, në këtë Institut anglishtja bëhet gjuha që çdo fëmijë e flet me pedagogë amerikanë, duke e shijuar përmes

përfaqësimi i njësuar dhe kon-turimi i një fytyre të re të London Language Intitute, e cila na përfaqëson dhe na bën të identifikueshëm në treg.

Identiteti i korporuar, i cili ka hyrë në tregun shqiptar relativisht



FOTO nga nje ore mesimi

zbavitjes.

“Falë kësaj London Language Institute rritet çdo vit.” – tregon Kristaq Gjoka duke u ngutur të shpjegojë se nuk e ka fjalën thjesht për regjistrimet.

Z.Gjoka thotë megjithatë se në biznes nuk mjafton të duash. “Duhet edhe të dish”.

- “Ne kemi pasur fatin të asitohemi nga programi BAS në Tiranë, për të profilizuar biznesin tonë. Asistenca e BAS na ka ndihmuar në targetimin më të mirë të tregut, duke nisur me konceptimin tërësor të profilit tonë”.

BAS, falë një ekspertize profesionale, na ka orientuar dhe mbështetur për të prodhuar një imazh të plotë të institutit duke nisur nga korrespondenca,

vonë, po fiton gjithnjë e më tepër rol në fuqizimin e aftësive konkurruese të bizneseve, që dinë ta shpërfaqin seriozitetin e tyre jo thjesht së jashtmi.

Për këtë arsye London Language Institute krahas kurseve për të rritur në të gjitha nivelet, kurseve përgatitore për çertifikatat e njohura të Cambridge: FCE, CAE, CPE, IELTS, si dhe për TOEFL, për të gjithë ata studentë që duan të ndjekin studime universitare, apo pas universitare jashtë shtetit, apo kurseve speciale në fushën e Biznesit, është e orientuar në kurset për fëmijët nga 5 deri në 14 vjeç.

Kristaq Gjoka beson se diferencimi në treg prodhohet nga marëdhënia me klientët, besueshmëria që krijon tek ata falë profesionalizmit dhe kënaqësisë së përbashkët që në London Language Institute, gjithmonë tingëllon anglisht.

